



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT
NË FUSHËN ENERGJETIKE**

Nr. 3152 Prot.

Tiranë, më 16.2 /2018

Lënda: Njoftim per fillimin e procedures se zgjidhjes se njeanshme te kontrates së koncesionit

**SHOQERISE KONÇESIONARE “HP BIGAS DHE VELESHNJE
ENERGY” SHPK.**

Njësia Administrative Qendër -Skrapar, Fshati Çerenisht, banesë private.

SKRAPAR

Per dijeni :

MINISTRISE SE TURIZMIT DHE MJEDISIT

AGJENCISE SE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

AGJENCISE KOMBETARE TE BURIMEVE NATYRORE ✓

TIRANE

Në lidhje me problemet e krijuara për zbatimin e kontratës së koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve “Bigas 1 & Bigas 2 dhe Veleshnje”, me nr.10282 Rep, & nr.3306 Kol, date 6.08.2013, e ndryshuar, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me Vendimin Nr.01, date 15.02.2018 ka njoftuar, për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ “Vendimi për VNM paraprake, Nr.13, Nr.137 identifikimi, datë 26.03.2015” për aktivitetin “Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike për hidrocentralet “Bigas 1 dhe Bigas 2”, në pellgun ujëmbledhës “Përroi i Bigasit”, Skrapar, (kopje bashkelidhur kesaj shkrese).

Gjithashtu njoftohemi se Agjencia e Zhvillimit të Territorit, ka kerkuar “Inspektimin ne terren me qellim pezullimin e punimeve për ndertimin e hidrocentraleve Bigas 1 & Bigas 2 dhe Veleshnje” deri ne vendimmarrjen e Ministrise se Turizmit dhe Mjedisit.

Në këto kushte, bazuar ne nenin 12 “Zgjidhja e kontrates se koncesionit” te kontratës se koncesionit për ndërtimin e hidrocentraleve “Bigas 1 & Bigas 2 dhe Veleshnje”, të ndryshuar, MIE, në cilësinë e Autortetit Kontraktues ju njofton per fillimin e procedures per zgjidhje te njeanshme te kontrates së koncesionit.

Në rast moskorigjimi të shkeljeve të mesiperme, brenda afatit të përcaktuar në nenin e sipërcituar, Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë të zgjidhur/perfunduar këtë kontratë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

